

NDËRMARRJA
PUBLIKE
BANESORE

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.

PLANI STRATEGJIK ZHVILLIMOR 2024-2026

Dhjetor



Përmbajtja

		Faqe
	<i>Të dhënat për biznesin</i>	3
	<i>Korniza ligjore</i>	4
	<i>Fjala Hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv</i>	5
1	<i>Hyrje dhe Metodologjia e përdorur</i>	6
2	<i>Struktura Organizative</i>	10
3	<i>Deklarata emisionit dhe vizionit</i>	11
4	<i>Konteksti dhe Situata Aktuale</i>	12
4.1	<i>Historiku</i>	12
4.2	<i>Burimet Njerëzore</i>	12
5	<i>S.W.O.T. analiza</i>	16
6	<i>Produktet dhe Shërbimet</i>	17
7	<i>Plani i qëndrueshmërisë</i>	19
7.1	<i>Tregu</i>	19
7.2	<i>Klientët</i>	19
8	<i>Konkurrenca</i>	21
9	<i>Menaxhimi i rrezikut</i>	22
10	<i>Prioritetet Strategjike</i>	23
11	<i>Plani i Veprimit</i>	25
12	<i>Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve Operative</i>	34
13	<i>Raportimi dhe Monitorimi</i>	35
	<i>Grupi punues</i>	37



Të dhënat për biznesin

Biznesi

Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.

Emri i biznesit	Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.
Emri tregtar	///
Lloji i biznesit	Shoqëri aksionare
Numri unik identifikues	810500604
Numri i biznesit	70170765
Numri fiskal	600390033

Vendndodhja e biznesit: Rr. Zija Shemsiu, Ulpianë, 10000, Prishtinë;

Viti i regjistrimit: 1946;

Komuna Prishtinë

Telefoni 38338606672

E-mail info@npbanesore.com

Pronari i biznesit: Komuna e Prishtinës;

Përfaqësues I autorizuar

<i>Emri</i>	<i>Mbiemri</i>	<i>Pozita në biznes</i>	<i>Autorizimet</i>
<i>Arton</i>	<i>Berisha</i>	<i>Kryeshef Ekzekutiv</i>	<i>Kryeshef Ekzekutiv</i>

Pronar/Aksionarë

<i>Pronar</i>	<i>Kapitali në %</i>
<i>Komuna e Prishtinës</i>	<i>100 %</i>

**Produktet/Shërbimet:****Aktivitet/et**

Kodi	Përshkrimi	Tipi
4120	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore	Primarë
8121	Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave	Sekondarë
6810	Blerja dhe shitja e patundshmërisë personale	Tjera
6820	Qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira	Tjera
6831	Agjencitë e patundshmërive	Tjera
6832	Manaxhimi i patundshmërisë në bazë të pagesës ose kontratës	Tjera
7112	Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik	Tjera
7120	Testimi teknik dhe analizat	Tjera
7219	Kërkime dhe zhvillime të tjera eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri	Tjera
4312	Përgatitja e vendpunishtes	Tjera
4313	Testi i shpuarjes dhe shpuarja	Tjera
4321	Instalime elektrike	Tjera
4322	Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit	Tjera
4329	Instalime të tjera ndërtimore	Tjera
4331	Punime suvatimi	Tjera
4332	Punime montimi nga druri dhe materiale të tjera	Tjera
4333	Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve	Tjera
4334	Lyerja dhe vendosja e xhamave	Tjera
4339	Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave	Tjera
4391	Punimet e kulmit (çatisë)	Tjera
4399	Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t.	Tjera

Korniza Ligjore

Ligji për Ndërmarrjet Publike me Nr 03/L-087, Ligji 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087, Ligji për Shoqëri Tregtare me Nr.06/L-016, Ligji i Punës me Nr.03/L-212, janë aktet me të cilat rregullohet menaxhimi i ndërmarrjeve publike. Dokumente tjera janë Statuti, Kodi Etikës dhe Rregulloret e Breshme të Ndërmarrjes.



Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv

Jam i lumtur të prezantoj para jush Vizionin dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të Qendrueshëm të Ndërmarrjes Publike Banesore. Vizioni dhe Plani Strategjik janë tashmë baza e politikave të zhvillimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm të Ndërmarrjes, në rritjen e ekonomisë dhe në modernizimin e qytetit tonë. Shumë nga ju kanë kontribuar në hartimin e Vizionit dhe Planit, dhe gjej rastin të shpreh falenderimet dhe mironjohjen time të sinqertë për kontributin dhe bashkëpunimin përgjatë kësaj periudhe të hartimit të këtij Plani. Ky është Vizioni juaj dhe unë do të jem me ju në realizimin hap pas hapi të tij. Realizimi i Vizionit dhe arritja e objektivave të Planit tonë do ta pozicionojë edhe më fuqishëm Ndërmarrjen.

Plani strategjik i Ndërmarrjes Publike Banesore për periudhën 2024- 2026 përcakton rrugët zhvillimore që do të ndjekë ky institucion gjatë tri viteve të ardhshme, duke përcaktuar në mënyrë të qartë objektivat zhvillimore dhe veprimet konkrete për realizimin e tyre. Ky dokument është zhvilluar në saje të një përfshirje të gjerë të personelit dhe udhëheqjes së Npb-së, të cilët mbi bazën e një rishikimi të të arriturave dhe sfidave të deritanishme, kanë arritur të përcaktojnë objektivat zhvillimore për tri vitet e ardhshme.

Plani është hartuar për të ndihmuar Npb-në që ta përmbushë vizionin e saj. Ai përcakton se si do t'i përgjigjemi kërkesave të ndryshme për ndërmarrjen tonë dhe i njëjti siguronë rritjen e mbledhjes së të hyrave duke mbështetur objektivat tona.

Nevoja për një ndërhyrje efektive, që mund të kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve publike, në përmirësimin e performancës dhe forcimin e kapaciteteve të ndërmarrjes, sjell domosdoshmërinë për të hartuar një dokument të tillë, i cili mund t'i identifikojë këto ndërhyrje, t'i bëjë ato përparësore dhe t'i vendosë ato në një kontekst më të madh, si në aspektin operativ dhe rrjedhimisht edhe në aspektin strategjik.

Npb-ja ka identifikuar një numër të objektivave strategjike, me qëllim që të avancojë pozitën konkurruese në ofrimin e shërbimeve cilësore për nevojat e qytetarëve. Për të arritur këtë qëllim, janë identifikuar prioritetet e tyre, duke u bazuar në kapacitetet dhe resurset njerëzore, financiare dhe logjistike, në mënyrë që të zhvillohen dhe udhëhiqen drejt përmbushjes së objektivave strategjike.

Për ne, Plani do të jetë udhërrëfyese i vetëm për të gjithë vendimmarrjen e rëndësishme në përcaktimin e prioriteteve tona për vitet në vazhdim. Unë jam i bindur se përfitues të rezultateve të Planit do të jenë të gjithë qytetarët, sipërmarrësit dhe njerëzit në nevojë, rinia, gratë dhe vajzat, dhe ndikimi i tij do të shtrihet përtej mureve të Npb-së, duke mbërritur tek çdo banorë dhe biznes në Kryeqytet. Bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve dhe faktorëve është jetik për realizimin me sukses të Planit, dhe Ndërmarrja do të krijojë të gjithë mjedisin e nevojshëm për ta mundur angazhimin dhe kontributet e të gjithë aktorëve në zhvillimin e qëndrueshëm të Qytetit.

Z. Arton Berisha

Kryeshef Ekzekutiv i Npb-së



1. Hyrje dhe Metodologjia e Përdorur

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A. Prishtinë, është përgjegjëse për themelimin dhe realizimin e politikave lidhur me veprimtarinë të cilën e ushtron, duke u përkushtuar që përmes veprimtarisë së përshkruar më poshtë të kontribuojë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

Veprimtaria e Ndërmarrjes përfshinë:

- *Ndërtimin e objekteve banesore-afariste, objekteve industriale, shkollave, spitaleve etj, duke i përfshirë edhe punët zeytare-përfundimtare;*
- *Mbikëqyrjen, projektimin, revidimin e projekteve, kontrollin teknik të objekteve, pranimin teknik;*
- *Administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave individuale dhe në bashkëpronësi;*
- *Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e lokaleve afariste të NDËRMARRJES PUBLIKE BANESORE SH.A. Prishtinë;*
- *Sanimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore, riparimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike;*

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A, është pronë e Komunës së Prishtinës e përbërë nga kapitali publik. Si e tillë kjo ndërmarrje ka për qëllim menaxhimin e drejtë dhe ruajtjen e pasurisë së saj e cila përbëhet prej patundshmërisë ku përfshihen banesa, lokale afariste, depo, garazha dhe truall.

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A., përbëhet nga 3 anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve, të cilët përzgjedhen nga Komuna e Prishtinës repsektivisht 1 anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës dhe 2 Anëtarë nga Kuvendi Komunal. Ky komision përmes procesit të rekrutimit përzgjedh 4 anëtarët e Bordit të Drejtorëve, kurse Bordi i Drejtorëve përmes të njëjtit proces, përzgjedh Kryeshefin/en Ekzekutiv/e, Sekretarin/en Koporativ/e, Zyrtarin/en i/e kryesor/e financiar/e dhe Auditorin/en e Brendshëm. KE është përgjegjës për organizimin e strukturave tjera të organizatës siç janë Drejtori i Operativës, Menaxherët e Departamenteve, etj.

Organizimi sipas Departamenteve:

- **Departamenti i mirëmbajtjes dhe renovimit të banesave:** *Renovimi i hapësirave të përbashkëta të ndërtesave shumë-banesore; administrimi dhe mirëmbajtja e rregullt e ndërtesave shumë-banesore, ashensorëve dhe objekteve tjera;*
- **Departamenti për intervenimeu urgjente në hapësirat publike:** *Sanimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore, mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik, riparimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike; prodhimi i dyerve, dritareve dhe produkteve tjera nga metali dhe alumini;*
- **Departamenti i Pronës dhe Qirasë:** *Ruajtja, administrimi dhe dhënia me qira e pasurive në pronësi të NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A. ;*
- **Departamenti për kujdes ndaj klientëve:** *Kontraktimet dhe takimet; menaxhimi i llogarive të klientëve; komunikim dhe kujdes ndaj klientëve.*



- **Departamenti i administrates:** Organizimi i brendshëm i NPB-së duke përfshi burimet njerëzore dhe punët tjera të administratës dhe logjistikës.
- **Departamenti i financave dhe thesarit:** Objektivi primar është menaxhimi i drejtë i parasë publike duke i zbatuar kodet dhe rregullat nderkombëtare si dhe marrja e opinionit të pakualifikuar nga auditori i jashtëm për të gjitha veprimet dhe transaksionet financiare.
- **Departamenti i Prokurimit:** Qëllimi dhe objektivi kryesor i prokurimit është që të realizohen blerje duke u bazuar në parime (principe), transparencë, konkurrencë, trajtim i barabartë, mosdiskriminim, racionalitet dhe efikasitet. Poashtu qëllimi kryesor është parandalimi i korrupsionit, të ketë disiplinë financiare dhe të ketë shpërndarje të drejtë.
- **Departamenti për zhvillim dhe planifikim strategjik:** Koordinon punën për organizimin e mbështetjes e të gjitha njësive brenda NPB-së, drejt hartimit të planeve strategjike për arritjen e misionit bazuar në vizionin e Ndërmarrjes
- **Departamenti ligjorë:** Ka përgjegjësi për të koordinuar kompletimin e kërkesave nga legjislacioni primar dhe sekondar në lëmin e çështjeve civile administrative dhe penale, që ndërlidhen me fushveprimtarinë e Ndërmarrjes Publike Banesore.

Metodologjia

Fillimisht lidhur me hartimin e këtij plani u shtruan katër çështje si në vijim:



Plani Strategjik Zhvillimor 2024-2026 është hartuar mbi bazën e një analize të detajuar që ka pasur për qëllim të vlerësojë proceset e brendshme dhe të jashtme. Ky vlerësim ka marrë për bazë sukseset e arritura, sfidat dhe zhvillimet e pritshme për periudhën e ardhshme



për NPB-në si dhe praktikat më të mira në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike. Procesi i hartimit të Strategjisë është udhëhequr nën mbikëqyrjen e menaxhmentit të NPB-së dhe se gjatë gjithë procesit të hartimit të Strategjisë janë përfshirë të gjithë anëtarët e njësisve organizative.

Procesi i hartimit të Strategjisë Zhvillimore të NPB-së dhe Planit të Veprimit 2024-2026 ka përfshirë disa faza:

- *Faza përgatitore – gjatë kësaj faze është bërë grumbullimi i materialeve relevante si dhe janë zhvilluar diskutime të përgjithshme rreth orientimeve strategjike mes nivelit të lartë menaxherial, është bërë analiza e palëve të interesit duke identifikuar aktorët kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm që mund të japin kontribut në procesin e hartimit.*
- *Themelimi i Grupit Punues për hartimin e Strategjisë Zhvillimore të NPB-së dhe Planit të Veprimit 2024-2026 - Qëllimi i themelimit të grupit punues ishte caktimi i personave përgjegjës, kompetentë dhe me përfaqësim nga të gjitha njësit organizative. Grupi punues ka ndërmarr këto veprime:*
- *Analizimi i gjendjes aktuale dhe shqyrtimi i të gjitha dokumenteve relevante dhe atyre operative në veçanti, përfshirë raportet e zbatimit të gjerëtanishëm, pastaj dinamikat zhvillimore aktuale dhe atyre të synuara, gjendja e strukturave dhe resurseve aktuale dhe projeksionet deri në vitin 2024, mbi bazën e të cilave pastaj është punuar në strukturën e dokumentit strategjik.*
- *Përcaktimi i misionit, vizionit, objektivave strategjik dhe specifike.*
- *Përmes punës interaktive në Grupe Punuese është ndërmarrë hapi tjetër që ka qenë një analizë SWOT, përmes së cilës janë identifikuar përparësitë, dobësitë (elemente të brendshme) dhe mundësitë me rreziqe (elemente të jashtme). Dhe mbi këtë bazë pastaj janë identifikuar problemet dhe vështirësitë të cilat duhet adresuar deri në vitin 2023.*
- *Hartimi i pjesës narrative të strategjisë.*
- *Hartimi i planit të veprimit të strategjisë.*
- *Konsultimi me akterët përkatës të strategjisë zhvillimore-Mbi këtë bazë është bërë analiza e problemeve në tërësinë e tyre duke rezultuar me riformulimin dhe përshtatjen e Objektivave Strategjike dhe atyre Specifike me zhvillimet aktuale dhe atyre në ardhje. Ndërkohë që janë futur edhe Objektiva Specifike të reja, të cilat synohet të arrihen deri në vitin 2026 kur edhe përfundon afati i këtij Plani Strategjik.*
- *Finalizimi i strategjisë – Pas përfundimit të procesit të konsultimeve, drafti i strategjisë është përcjellë për miratim tek Kryeshefi Ekzekutiv dhe Bordi I NPB-së*

Qëllimi i Planit është që të shqyrtojë rendësinë e implementimit të aktiviteteve të menaxhimit strategjik në zhvillimin e biznesit, duke ndikuar në rritjen e performancës së biznesit në tregun ku aktualisht kompania zhvillon aktivitetet e veta biznesore. Analiza është mbështetur në kompaninë e cila zhvillon biznes që një kohë të gjatë (76 vjeqare). Në bazë të hulumtimit identifikimi dhe zgjedhja e strategjisë së ndërmarrjes është një process shumë i rëndësishëm për menaxhimin, ngase nga identifikimi i strategjive më të



përshatshme bëhet zgjedhja e strategjive adekuate dhe këto strategji përcaktojnë veprimet që duhet të ndërmerren menaxhimi për përmbushjen e qëllimit të ndërmarrjes. Fokusi është zhvilluar në bazë të rëndësisë së menaxhimit strategjik si fushë dhe rëndësia e hartimit të strategjive në ndërmarrje në përputhje me vizionin dhe misionin e kompanisë në aspektin teorik dhe praktik. Në bazë të organogramit, menaxherëve duhet t' i kushtojmë një rëndësi të veçantë duke përcaktuar praktikën më të mira për shërbime që ofrohen për qytetarët, krijimin e strategjive adekuate që kanë ndikim në rritjen e biznesit duke bërë analizën e tregut ku operon biznesi, identifikimin e alternativave strategjike më me potencial për biznesin, vlerësimin e strategjive më adekuate dhe zgjedhjen e strategjive më të duhura për biznesin. Synimi primar i zhvillimit është identifikimi i faktorëve më të rëndësishëm që kanë ndikim në zhvillimin e ndërmarrjes.

Ndërmarrja paraqet të gjithë njerëzit që bashkëpunojnë njëri me tjetrin me qëllim që t' i realizojnë qëllimin e synuar nga organizata. Personat që ndjekin procesin e realizimit të qëllimit të organizatës janë menaxherët që zhvillojnë katër funksionet si; planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin, që i ndihmojnë në vlerësimin e procesit të arritjes së synimeve të organizatës.

Organizata në mënyrë të vazhdueshme duhet të angazhojë menaxherë të cilët punojnë në mënyrë të vazhdueshme në të mirë të biznesit, duke realizuar në mënyrë shumë efektive funksionet e tyre, që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga organizata. Menaxherët që t' i rrisin mundësitë që biznesi i tyre të jetë i suksesshëm në treg duhet t' i kenë në konsideratë katër faktorë të cilët kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në rritjen e jetëgjatësisë së biznesit duke filluar nga zgjedhja e veprimtarisë së biznesit, që të ketë potencial diversifikimi, krijimi i strategjive me potencial për biznesin duke bërë analizën e tregut, identifikimin e alternativave strategjike, vlerësimin e tyre dhe duke bërë zgjedhjen e strategjive të duhura për biznesin. Faktorë tjetër me rëndësi është edhe projektimi dhe zhvillimi i sistemeve dhe strukturave brenda firmës, që të kenë lidhshmëri me strategjitë e firmës, përdorimi i burimeve të firmës në mënyrë korrekte si burimet njerëzore, që kanë një rëndësi të madhe në suksesin e firmës duhet t' i kushtohet një rëndësi të madhe trajtimit të tyre dhe përzgjedhjes së tyre.

Faktorë që kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në rritjen e jetëgjatësisë së biznesit:

- 1 • Zgjedhja e veprimtarisë të biznesit
- 2 • Krijimi i strategjive me potencial për biznesin
- 3 • Identifikimin e alternativave strategjike
- 4 • Vlerësimin e tyre dhe duke bërë zgjedhjen e strategjive të duhura
- 5 • Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve dhe strukturave brenda firmës



3. Deklarata e Misionit dhe Vizionit

Plani Strategjik 2024-2026 paraqet drejtimin për përmbushjen e misionit dhe vizionit tonë gjatë tri viteve të ardhshme.

MISIONI

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.të jetë kompania kryesore për administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi. Të jetë kompania kryesore për intervenime të shpejta ndërtimore dhe infrastrukturore në hapësirat publike në të gjithë territorin e Komunës së Prishtinës -në çdo kohë (24/7); Të realizoj projekte për rigjenerimin e lagjeve të urbanizuara në qytetin e Prishtinës në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës dhe pronarët e njësisve banesore. Të ruaj, administroj dhe të jap me qira pasuritë në pronësi të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A; Rritja e pasurisë përmes ndërtimit ne parcelat ku është paraparë ndërtimi i lartë sipas planeve urbanistike;

VIZIONI

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.të bëhet sinonim i jetës së organizuar dhe të shëndetshme në Prishtinë, dhe të njihet si shembull i përsosshmërisë në shërbimet për qytetarët e Prishtinës si dhe të jetë iniciatore e ndërtimit të një sistemi i cili do të mundësoj që të kemi politika të qëndrueshme për qytetin dhe veprimtarinë njerëzore.

VLERAT

- Profesionalizmi dhe përgjegjshmëria personale
- Integriteti dhe ndershmëria - trajtim i drejtë i njerëzve dhe zbatim i drejtë i ligjit
- Respekti - trajtimi i kolegëve dhe tatimpaguesve me dinjitet
- Fleksibiliteti - do të thotë të përshtatemi dhe të reagojmë shpejtë ndaj mjedisit të jashtëm
- Transparenca - nënkupton hapje ndaj publikut



4. Konteksti dhe Situata Aktuale

4.1 Historiku

Në vitin 1946 Kuvendi Komunal i Prishtinës formoi Departamentin e Mirëmbajtjes së Ndërtesave, detyrë e së cilit ishte ruajtja dhe mirëmbajtja e pronës publike. Ndonëse ky departament kryente punë të natyrës së Ndërmarrjes, kjo e fundit nuk ishte themeluar ende. Zyrtarisht, Ndërmarrja e Banesave në Prishtinë, siç quhej në fillim, është themeluar në vitin 1964 pas formimit të fondit banesor, i cili ishte krijuar nga ndalesa prej 3.35% e pagës bruto e të punësuarve në atë kohë. Në vitin 1976, Ndërmarrja e Banesave u transformua në Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit për Banim dhe Lokale Afarist (BVI-ja për Banim dhe Lokale Afariste). Me suprimimin e autonomisë së

- Kosovës në vitin 1989, dhe rrënimin e sistemit juridik e institucional nga regjimi i Serbisë, Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit për Banim dhe Lokale Afariste u transformua duke ju ndryshuar emri në Ndërmarrja Publike Banesore.
- Pas çlirimit të Kosovës, ndërmarrja është regjistruar në vitin 2000 dhe ri-regjistruar në vitin 2004 në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë si Ndërmarrja Publike Banesore.

4.2 Burimet Njerëzore

Mundësitë e rekrutimit - Plotësimi i nevojave të burimeve njerëzore bëhet duke u mbështetur në strategjinë e ndërmarrjes. Në njerën anë, përmes rekrutimit synojmë që të sigurojmë akumulimin e talentit - persona të cilët mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave të organizatës. Në anën tjetër, NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A. synon që përmes zhvillimit të një kulture të hapur dhe kolektive të formon një mjedis produktiv dhe kreativ në zgjidhjen e problemeve.



Ndërmarrja praktikon dy lloje të rekrutimit: rekrutimin e brendshëm dhe rekrutimin e jashtëm. Rekrutimi i brendshëm mundëson përparimin e të punësuarëve brenda ndërmarrjes duke i ngritur në detyrë për të krijuar hapësirë që të dëshmojnë aftësitë e tyre të fituara në ndërmarrje. Ky proces i rekrutimit nga burimet e brendshme kryesisht bëhet nëpërmjet: shpalljes, propozimit - rekomandimit të menaxherëve, rekomandimit të sektorit për burime njerëzore. Kurse, rekrutimi i jashtëm synon futjen e ideve të reja përkatësisht futjen e kualifikimeve të reja duke rritur mundësinë e sjelljes së talentëve. Ky rekrutim bëhet përmes shpalljeve të konkurseve në gazeta, media të shkruara dhe elektronike, agjenci për punësim etj.

Programet e trajnimit: *Gjatë punës në NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A. , personeli ka mundësi të avancojë njohuritë që posedon apo edhe të shtojë njohuri dhe aftësi të reja. Personeli i ri, domosdoshmërisht, duhet të kalojë përmes trajnimit për orientim, i cili mbahet në fillim të kontratës/detyrës së tyre. Ky trajnim përpilohet nga zyrtarët e burimeve njerëzore dhe ka për qëllim të përgatitë personelin e ri mbi misionin dhe vizionin e ndërmarrjes, kulturën e ndërmarrjes, strukturën organizative dhe lidhësin, politikën e ndërmarrjes, etikën në ndërmarrje, si dhe procedurat administrative (krijimi i kredencialeve, e-mailit).*

Kompensimi i punëtorëve: *Secili punonjës merr pagën sipas kontratës, e cila përfshinë përshkrimin e vendit të punës, detyrat, përgjegjësitë dhe detyrimet e tjera bazuar në ligjin e punës dhe ligjet tjera relevante në fuqi. Gjithashtu, secilit punonjës i shpërndahet shuma prej 5 euro për shujtën ditore.*

Sigurimi i punëtorëve: *Secili punonjës posedon sigurim shëndetësor i cili mbulon shpenzimet shëndetësore konform kontratës me kompaninë e sigurimit. Gjithashtu, punonjësit të cilët i ekspozohen rrezikut në punë udhëzohen apo u jepën instruksione relevante për siguri në punë. Për më shumë, ata pajisen edhe me uniforma dhe mjete adekuate për mbrojtje.*

Vlerësimi i performancës: *Sistemi i vlerësimit të performancës përbëhet nga tërësia e aktiviteteve të planifikuara, të organizuara dhe të kontrolluara, me qëllim që të vrojtohet, të matet, të gjykohet dhe të përmirësohet kontributi i punonjësve në objektivat e kompanisë. Ky sistem i vlerësimit përfshinë formularët standard të organizatës që janë të përbërë nga: objektivat e vlerësimit, kriteret e vlerësimit, normat, matjet dhe metodat. Konform këtyre kushteve bëhet vlerësimi i secilit punonjës së paku një herë në vit duke u vlerësuar nga personat përgjegjës sipas niveleve të organizimit të paraqitura në organogram.*

Qëllimi :

- *Sigurimi i zbatimit të procedurave ligjore në lidhje me punën dhe zhvillimin e stafit.*

Strategjitë dhe veprimet:

- *Identifikimi i nevojave të Departamenteve për të plotësuar vendet vakante.*
- *Mbikëqyrja e procedurave të rekrutimit dhe vlerësimit të aplikantëve nga Komisionet vlerësuese.*
- *Rritja e përdorimit të burimeve të brendshme për promovim dhe zhvillim të stafit.*

Zhvillimi i kapaciteteve të stafit:

- *Identifikimi i nevojave për trajnim dhe zhvillim të stafit.*
- *Hartimi i një plani trajnimi dhe sigurimi i mundësisë për këto trajnime.*
- *Ndihma për zhvillimin e punonjësve për të përmbushur detyrat me efikasitet.*



Menaxhimi i performancës dhe motivimi i punonjësve:

- Vendosja e një sistemi të qartë të vlerësimit të performances;
- Përmirësimi i procesit të kompensimit dhe motivimi për punonjësit;
- Përmirësimi i komunikimit të brendshëm për të nxitur ndjenjën e përkatësisë ndaj Ndërmarrjes.

Promovimi i Rritjes së Përfshirjes së Grave në Vendimmarrje

Ndërmarrja Publike Banesore e Prishtinës (NPB) është e vendosur të promovojë dhe të rrisë përfshirjen e grave në procesin e vendimmarrjes. Ne e konsiderojmë përfshirjen e barabartë të gjinisë në procesin vendimmarrës si një avantazh të madh për organizatën tonë. Gratë sjellin perspektiva të ndryshme dhe diversitet në procesin vendimmarrës. Ky diversitet mund të kontribuojë në zgjidhjen më të mirë të problematikave komplekse dhe në zhvillimin e strategjive të reja. Përfshirja e grave në vendimmarrje reflekton më mirë strukturën dhe diversitetin e shoqërisë së përgjithshme. Në këtë mënyrë, organizata tregon përgjegjësi sociale dhe ndihmon në zhvillimin e një mjedisi të barabartë.

Promovimi i Përfshirjes së Personave me Nevoja të Vecanta në Ndërmarrjen Publike Banesore (NPB)

Ndërmarrja Publike Banesore e Prishtinës është e përkushtuar ndaj një përfshirje të barabartë dhe të drejtë të të gjithë anëtarëve të komunitetit tonë në jetën dhe punën e organizatës. Kështu, ne jemi të vendosur të promovojmë dhe të rrisim përfshirjen e personave me nevoja të vecanta në NPB. Për momentin, ne kemi 6 persona me nevoja të vecanta në organizatën tonë, dhe kemi një plan të qartë për të kujdesur dhe për të përmirësuar përfshirjen e tyre.

Personat me nevoja të vecanta sjellin perspektiva të ndryshme dhe diversitet në organizatë. Përmes përfshirjes së tyre, ne mund të zhvillojmë shërbime që janë më të përshtatshme dhe më të ndjeshme ndaj nevojave të të gjithë komunitetit.

Përfshirja e personave me nevoja të vecanta është një shprehje e respektit të plotë ndaj të drejtave të njeriut dhe barazisë. Ne duam të sigurojmë që të gjithë punonjësit e Ndërmarrjes të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe për të zhvilluar veten në vendin e punës.

Ndërmarrja planifikon politika dhe programe mbështetëse për të siguruar që personat me nevoja të veçanta të kenë të drejta të barabarta në punë dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Këshillim dhe komunikim të hapur:

Ne inkurajojmë komunikimin e hapur dhe këshillimin e rregullt me personat me nevoja të vecanta për të kuptuar nevojat dhe shqetësimet e tyre dhe për të ofruar mbështetjen e duhur.

Ne e shohim përfshirjen e personave me nevoja të vecanta si një investim në diversitetin dhe fuqinë e organizatës sonë. Përmes kësaj përfshirjeje, ne synojmë të bëhemi një organizatë më e pasur dhe më e përshtatshme për të gjithë, duke ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë.

Dixhitalizimi i arkivës

Ky plan përfshin edhe arkivën e cila do të dixhitalizohet në vitin 2024-2026



Dixhitalizimi i Arkivës do të fokusohet kryesisht në:

- *Identifikimin e dokumenteve dhe regjistrave të rëndësishëm për dixhitalizim: Identifikimi i materialeve të arkivës që duhet të skanohen dhe të konvertohen në format elektronike.*
- *Hartimin e procedurave për skanimin dhe ruajtjen e dokumenteve elektronikë: Përcaktimi i metodave të skanimit, indeksimit dhe ruajtjes së dokumenteve elektronikë për të siguruar që ata të jenë të arritshëm dhe të mbrohen.*

Kjo procedurë do të përfshinjë dixhitalizimin e arkivës për të përmirësuar qasjen dhe menaxhimin e dokumentacionit të organizatës, duke e bërë atë më efikase dhe të sigurt.

Procesi i dixhitalizimit do të realizohet përmes një kompanie të jashtme profesionale, me staf të mjaftueshëm që garanton që ky proces të përfundojë me sukses duke funksionalizuar të gjitha kërkesat dhe nevojat që paraqiten nga institucioni ynë.

Teknologjia Informative

Përmirësimi i Infrastrukturës IT: Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës IT për të garantuar që Ndërmarrja të ketë një sistemi të qëndrueshëm dhe të sigurtë për të përmbushur nevojat e saj. Kjo përfshin përdorimin e teknologjive të fundit, azhurnimin e pajisjeve dhe krijimin e një mjedisi të sigurt të rrjetit.

Rritja e Sigurisë Informatike: Përmirësimi i sigurisë së informacionit dhe parandalimi i rreziqeve të mundshme kibernetike. Kjo përfshin trajnimin e stafit dhe ndërtimin e një mbrojtje të fortë ndaj kërcënimeve të sigurisë.

Përmirësimi i Shërbimeve Teknologjike: Përmirësimi i shërbimeve të ofruara nga Divizioni i IT për të plotësuar më mirë nevojat e departamenteve të Ndërmarrjes. Kjo përfshin ndërtime të aplikacioneve të reja, përmirësimin e ndihmës së teknologjisë për përdoruesit, dhe ofrimin e zgjidhjeve të personalizuar për departamentet.

Përmirësimi i Efikasitetit dhe Produktivitetit: Kërkimi i mundësive për të rritur efikasitetin e përdorimit të teknologjisë dhe për të ndihmuar në rritjen e produktivitetit të punonjësve. Kjo përfshin automatizimin e proceseve, zhvillimin e aplikacioneve të menaxhimit të projekteve dhe promovimin e përdorimit të mjeteve bashkëpunuese.

Mbështetja e Zhvillimit të Mëtejshëm: Sigurimi i mundësisë për të krijuar dhe ndërtuar kapacitete të reja të teknologjisë dhe për të ndihmuar në zhvillimin e njohurive të stafit në fushën e IT. Kjo përfshin ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme dhe krijimin e mundësive për zhvillim karriere.

Sigurimi i backup-ave dhe sigurisë së dokumentacionit të dixhitalizuar: Planifikimi i procedurave për backup dhe ruajtjen e sigurt të dokumentacionit elektronik për të parandaluar humbjen ose dëmtimin e të dhënave të rëndësishme.




5. S.W.O.T. analiza

Fuqitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none">- Tradita dhe përvoja e gjatë (77 vite) e ndërmarrjes.- Lojaliteti dhe besimi i konsumatorëve.- E vetmja ndërmarrje publike që ofron shërbimet e tilla.- Bashkëpunimi i mirë me institucionet e nivelit lokal.- Posedimi i konsiderueshëm i kapitalit (mjete të disponueshme për investime).- Stafi menaxhues kreativ.- Posedimi i projekteve arkitekturore të ndërtesave kolektive.- Numri i konsiderueshëm i punonjësve që kryejnë shërbime.- Posedimi i hapësirave të mjaftueshme të punës dhe mjeteve moderne të punës.- Niveli i kënaqshëm i transparencës. <p>Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve.</p>	<ul style="list-style-type: none">- Burokracia dhe procedurat e tej zgjata në prokurimin publik zvarrit punët dhe pengon blerjen e shpejtë të produkteve apo shërbimeve që nevojiten.- Burokracia dhe procedurat e tej zgjata në burime njerëzore për rekrutimin e stafit të nevojshëm që vështirëson përmbushjen e objektivave përbrenda afateve kohore.- Mungesa e mjaftueshme e kulturës në punë si pasojë e sistemit të brishtë të edukimit.- Mungesa e një platforme të avancuar softëare-ike për integrimin e aktiviteteve biznesore, duke përfshirë databazën e konsumatorëve.
Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none">- Kërkesa e madhe për administrimin e hapësirave në bashkëpronësi – mundësia e zgjerimit në administrimin e hyrjeve.- Nevoja e madhe për intervenime urgjente në qytet.- Paaftësia/pazotësia e kompanive private për të ofruar këto shërbime.- Krijimi i partneriteteve me institucione relevante. <p>Lidhja e marrëveshjeve me Komunën e Prishtinës dhe organizatave tjera publike përmes kontratës "blerje brenda shtëpisë. Këto Kontrata lidhen në konsideratë dhe në bazë të Nenit 9 paragrafi 4 të Ligjit të prokurimit publik, dhe interpretimit ligjor nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të datës 03.11.2016 të publikuar nga KRPP në Seksionin Ndihmë.</p>	<ul style="list-style-type: none">- Mungesa e sundimit të ligjit.- Burokracia dhe procedurat e tej zgjata që manifestohen me zvarritje të punëve nga nënpunësit dhe pengojnë zgjidhjen e shpejt të çështjeve.- Mungesa e kualifikimit të përshtatshëm të punonjësve në treg.- Lëvizjet demografike – niveli i lartë i emigracionit, sidomos tek fuqia punëtore e re dhe e kualifikuar.- Shkalla e lartë e informalitetit.- Mungesa e ligjeve adekuate që adresojnë problemet në bashkëpronësi.- Mungesa e fondit të banimit.- Normat e larta të interesit bankar. <p>Konkurrenca jolojale e cila cenon praktikën e mira afariste.</p>

6. Produktet/shërbimet

Shërbimet që orohen nga Npb-ja:



Pozicioni i tregut: Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. është e vetmja kompani publike që ushtron këtë veprimtari në Republikën e Kosovës. Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. funksionon duke u bazuar edhe në nevojat publike; kriteri i vlerësimit të këtyre nevojave më tepër shkon drejtë shfrytëzimit racional të mjeteve publike sesa në drejtim të ekonomizimit. Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. ka pozicion të favorshëm në treg për shkak që shfrytëzon avantazhin krahasues si kompani publike e cila nuk mund ta ketë profitin si të vetmin qëllim, por ka edhe qëllimet e tjera siç janë: të ofrojë shërbime të karakterit publik, të ofroj shërbime sa më cilësore dhe në afate sa më të shkurta dhe që përfitues të shërbimeve të jenë sa më shumë qytetar, duke u përpjekur që me sa më pak mjete dhe shpenzime të arrihet efekti i dëshiruar dhe duke i'u përmbajtur parimeve ekonomike në ekonominë publike, që kryesisht manifestohen nëpërmjet "kursimit", domethënë, shfrytëzimit racional të mjeteve publike.

Pozicioni unik i shitjes: Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. ka pozicion të favorshëm në treg në shërbimet e ofruara, meqenëse Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. si ndërmarrje publike, prodhon apo distribuon të "mira esenciale". Meqenëse këto të mira janë tejet të nevojshme për qytetarët, Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. ka marrur përgjegjësinë që të ofroj këto shërbime. Domethënë, Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. kryesisht funksionon në ato degë që kanë rëndësi të veçantë për mirëqenien e qytetarëve dhe që



zakonisht për këto degë kërkojnë investime shumë të mëdha, ose kur entitetet private nuk ka interes të angazhohen për shkak të profitit të vogël, siç është rasti me administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi; shumë kompani private që nga pas lufta kanë tentuar që të ofrojnë këto shërbime mirëpo nuk kanë pasur sukses. Arsyeja kryesore e mospasjes ka qenë nevoja e madhe për investime në hyrjet e ndërtesave në bashkëpronësi, kthimi afatgjatë i investimeve dhe problemi me inkasimin e të hyrave etj. Poashtu, shumë kontrata të lidhura në mes Komunës së Prishtinës dhe Operatorëve Privat për intervenime urgjente nuk kanë arritur të implementohen me kohë edhe pse kërkesa për intervenime kanë qenë të karakterit urgjent. Për të tejkaluar vonesat e mundshme në intervenime urgjente, Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. ka krijuar ekipe enkas për intervenime urgjente me ç'rast do të angazhohen për t'i sanuar problemet në qytet në vazhdimësi, në çdo kohë (24/7) në turne të ndryshme.

Kërkesa e parashikuar: Klientët tanë kryesisht janë qytetarët e Prishtinës që banojnë në objektet shumë-banesore, Komuna e Prishtinës, Ndërmarrjet Publike Lokale, Ndërmarrjet Publike Regjionale si dhe afarist të ndryshëm në cilësinë e qiramarrësve të pronave të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A., mirëpo përfituesit përfundimtar të këtyre të mirave janë qytetarët e Prishtinës.

Strategjia e çmimeve: Kalkulimi i çmimeve kryesisht bëhet përmes metodës "Kosto Plus" (Cost-Plus Pricing)- një metodë e vendosjes së çmimit, ku çmimi i shitjes vendoset duke i vlerësuar të gjitha kostot dhe duke shtuar një përqindje për të krijuar çmimin final. Duke pasur parasysh që Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. bazohet edhe në nevojat publike, kryesisht profiti është i ulët dhe së çmimet për produktet dhe shërbimet janë të arsyeshme dhe të përballeshëm për të gjitha shtresat shoqërore.

Risi/Inovacioni- Kërkime dhe zhvillim/aktivitete të inovacionit : Përgjatë zhvillimit të departamenteve janë konsultuar përvojat më të mira të qyteteve në Bashkimin e Evropian si dhe të kryeqyteteve të rajonit.

Edhe pse vendi ynë ka specifika të veçanta për shkak të zhvillimit jo normal të tranzicionit në krahësim më vendet e lartpërmendura, ne jemi bazuar në praktikën më të mira të vendeve të rajonit për administrimin e bashkëpronësisë. Pas hulumtimit të tregut gjatë zhvillimit të Departamentit të Mirëmbajtjes kemi kuptuar se investimet në hyrjet e ndërtesave në bashkëpronësi janë të domosdoshme për t'u shtrirë në treg. Kjo iniciativë ka hasur në përkrahje nga të gjithë qytetarët e Prishtinës. Investimi fillestar financohet nga kursimet e Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. të gjeneruara nga qiraja e lokaleve afariste kurse kthimi i investimit duke përfshirë edhe fitimin bëhet sipas kontratës për mirëmbajtje dhe investimit me pronarët e njësisve banesore. Sipas praktikës së kryeqyteteve në fjalë kemi vërejtur se intervenimet urgjente ndërtime ekzekutohen përmes kompanive publike të cilat bartin njësi të veçanta për ndërhyrjet urgjente në hapësirat publike. Arsyeja kryesore e kësaj praktike del të jetë shpejtësia në intervenime. Adresimi i shpejt i problemeve dhe zgjidhja e tyre në afat të shkurtër ka dëshmuar të jetë shumë e rëndësishme për mbarëvatjen normale të punëve në një qytet. Departamenti i Intervenimeve Urgjente dhe ai i Projektimit kryesisht do të realizojnë punën publike si rrjedhojë e kësaj do të gjenerojnë të hyra kryesisht nga projektet e Komunës së Prishtinës, Ndërmarrjet Publike Lokale dhe Ndërmarrjet Publike Regjionale. Kurse, departamenti për kujdes ndaj klientëve është departament mbështetës për të gjitha Departamentet.



7. Plani i qëndrueshmërisë

Duke besuar që shoqëria dhe mjedisi janë të pandashme, NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A. synon që të ketë projekte të qëndrueshme të cilat fokusohen në përmbushjen e nevojave të tanishme të shoqërisë, pa e kompromentuar mundësinë që edhe gjenerateve të ardhshme t'i përmbushën këto nevoja.

